



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

KALENDAR I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së, Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për hartimin e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027

Procesi i hartimit të buxhetit është shumë i rëndësishëm për qytetarët e komunës së Skenderajt, të cilët nëpërmjet propozimeve dhe kërkesave për investime kapitale për vitin e ardhshëm, bëhen pjesë e vendimmarrjes në komunitetin e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të mbahen me datat 21 dhe 22 gusht, sipas kalendarit të detajuar.

Në këto takime mund të marrin pjesë qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve, organizatat e shoqërisë civile, komunitetet e ndryshme, grupe të caktuara të interesit, gratë, pensionistët, të rinjtë, klubet sportive, përfaqësues të komunitetit të biznesit, etj.

Nr.	Dëgjimi buxhetor me qytetarë për hartimin e buxhetit 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027	Dita/data e mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Vendi i mbajtjes	Ora
1.	Dëgjim buxhetor	E mërkurë, 21 gusht 2024	Klinë e Epërme, në Shkollën "Idriz Berani"	13:30
2.	Dëgjim buxhetor	E mërkurë, 21 gusht 2024	Runik, në Shkollën "Shotë Galica"	15:30
3.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Turiqec, në Shkollën "Abedin Rexha"	13:30
4.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Salla e Kuvendit Komunal, Kati IV	15:00

Komentet, kërkesat dhe sugjerimet lidhur me procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027, mund t'i dërgoni në emailat: ismet.aliu@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net


Amir Lushtaku
Kryedhëyesi për Komunikim me Publikun